

V E N D I M
Nr.328, datë 30.6.1993

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndihma ekonomike mujore e plotë për familjet në qytet e në fshat llogaritet mbi bazën e përkrahjes sociale minimale ose maksimale. Për efekt të llogaritjes së kësaj ndihme, në masën e përkrahjes sociale nuk përfshihet ndihma shoqërore e parashikuar në nenin 4/a të ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike".

2. Masa e ndihmës ekonomike mujore të plotë, në varësi nga numri i anëtarëve të familjes llogaritet si vijon:

Familja me 2 anëtarë 70% e shumës së dy përkrahjeve sociale minim.
Familja me 3 anëtarë 75% e shumës së dy përkrahjeve sociale minim.
Familja me 4 anëtarë 80% e shumës së dy përkrahjeve sociale maksim.
Familja me 5 anëtarë 83% e shumës së dy përkrahjeve sociale maksim.
Familja me 6 anëtarë 87% e shumës së dy përkrahjeve sociale maksim.
Familja me 7 anëtarë 92% e shumës së dy përkrahjeve sociale maksim.

Këshilli i bashkisë ose i komunës, për familje mbi 7 anëtarë vendos për masën e ndihmës së plotë mujore më të lartë se 92% e shumës së dy përkrahjeve sociale maksimale, por pa kaluar 100% të tyre. Familja me një anëtar përfiton ndihmë ekonomike mujore të plotë në masën 95% të një përkrahje sociale minimale.

3. Ndihma ekonomike mujore e pjesshme për familjen me të ardhura të pamjaftueshme në qytet e në fshat llogaritet si diferencë ndërmjet nivelit të ndihmës ekonomike mujore të plotë që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi, dhe të ardhurave aktuale të familjes, në të cilat përfshihen edhe të ardhurat nga toka. Ndihma ekonomike mujore e pjesshme nuk është më e vogël se 10% e ndihmës ekonomike të plotë mujore.

4. Familja që përfiton ndihmë ekonomike të plotë, përfiton edhe kompensim për frymë nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, dhe kompensim për frymë si efekt i rritjes së çmimit të bukës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993.

5. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike mujore të pjesshme vetëm si rezultat i të ardhurave nga toka, do të përfitojnë kompensim edhe 203 lekë për frymë në muaj, si efekt i rritjes së çmimit të bukës.

6. Pagesa e ndihmës ekonomike bëhet në bashki dhe komuna nga personeli llogaritar arkëtar i tyre.

7. Fondi i financimit të ndihmës ekonomike sipas këtij vendimi për 6-mujorin e dytë të vitit 1993 përbëhet nga:

- a) fondi i planifikuar për ndihmë ekonomike në buxhetin e vitit 1993 për 300 milionë lekë;
- b) fonde të papërdorura në buxhetin e vitit 1993 të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale ka të drejtën e përdorimit 6-mujor të këtij fondi.

8. Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë she e Ushqimit ngarkohen të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.428, datë 5.10.1992 "Për kriteret e dhënies së përkrahjes ekonomike familjeve fshatare me sipërfaqe të kufizuar toke dhe të ardhura të pakta", ndryshuar me vendimet nr.110, datë 6.3.1993, dhe pikat 8 e 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave

nr.275, datë 13.6.1993, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.154, datë 3.4.1993 "Për dhënien e ndihmës ekonomike personave që u mbaron afati i përkrahjes sociale", dhe udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 7.10.1968 "Për ndihmën ekonomike personave të paaftë për punë që nuk kanë të ardhura dhe që janë pa ndihmë", me gjithë ndryshimet e mëvonshme, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi